

Hapet thirrja për aplikime për bursa në kuadër të programit Erasmus+ KA107 në Universitetin e Granadës në Spanjë, për stafin akademik të Universitetit të Tiranës për mësimdhënie për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin e Granadës në Spanjë, për stafin akademik të Universitetit të Tiranës për mësimdhënie.

Llojet e mobilitetit /kohëzgjatja:

-Shkëmbimin e stafit akademik (5 ditë+2 ditët e udhëtimit);

*Mobiliteti për mësimdhënie duhet të kryhet brenda muajit korrik 2019.

Pë t'u njohur me fushat e studimit referohuni linkut:

<https://internacional.ugr.es>

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin ditor për stafin (120 EUR në ditë);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik të Universitetit të Tiranës:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);

- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze niveli B2);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo më parë një mobilitet në kuadër të programit Erasmus+;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

*Plani i Mobilitetit për mësimdhënie është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënies. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Afati për aplikim: 14 Shkurt 2019

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara në formatin PDF dhe të dërgohen në adresën iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!